



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 463-01/49363, datë: 30. Qershor 2020.

Në bazë të dispozitave të nenit 11, dhe nenit 17 paragrafi 1 pika b) i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28, dt. 04.06.2008"), nenit 4 paragrafi 2. nënpika 2.4.1 të Ligjit Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nenit 8 dhe nenit 14 paragrafi 1 pika b) të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Nr. 09-8103 dt. 29.09.2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me dt. 30 Qershor 2020, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, muarr këtë:

V E N D I M

Nr. 33/2020

MBI SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK

IMIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës ashtu që **SHPALLET** interesi publik me qëllim të realizimit të projektit: Formimi i rrugës në Pejë sipas Planit Rregullues Urban.

Për tu realizuar një projekt i tillë, prek interesat e pronës private, prek një pjesë prej 328 m² të ngastrës kadastrale 5894/6 e cila ka sipërfaqen totale prej 4006 m² ZK Pejë të bashkëpronarëve **Hoxha Ahmet, Hoxha Mustaf, Shoshi Xhevahire, Haxhija Jusuf, Haxhiu Nysret, Haxhija Emin, Haxhija Enver, dhe Haxhija Esad nga Peja** të identifikuar në çërfikatën e pronës.

II. Shpallja e interesit publik bëhet me qëllim që paluajtshmëria e përshkruar në pikën I të këtij Vendimi, të kalojë në pronësi të Komunës, pas një procedure të shpronësimit apo këmbimit, për realizimin e qëllimit publik: Formimi dhe ndërtimi i rrugës në Pejë.

III. Prona e shpallur si interes publik në pikën I të këtij Vendimi do të shërbejë ekskluzivisht për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik.

IV. Në bazë të këtij Vendimi, Kryetari i Komunës do të iniciojë procedurat e mëtutjeshme për shpronësimin apo këmbimin e pronës në fjalë për interes publik konform dispozitave ligjore në fuqi.

V. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Çështje Pronësoro-Juridike.

IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.


Vendimi ti dërgohet:

1x1 MAPL-së

1x1 Kryetarit të Komunës

1x1 DÇPJ

1x1 Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT

Dr. Islam Husaj